

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës – Punë

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS:

Rehabilitim rrjeti i jashtem fshati Çepune -Ura e Kardhiqit (Njesia Gjirokaster)

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

45000000-7

VLERA E FONDIT LIMIT:

2,999,381.7 Dy milionë e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e treqind e tetëdhjetë e një pikë shtatë leke pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Shoqeria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Gjirokaster Sh.A** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në Nenet 76, 82 dhe 83 të LPP dhe Nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

- Sipas kriterëve të përgjithshme

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2022, 2023, 2024), ku vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së përllogaritur të kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP-së, i ndryshuar, si dhe nenet 43 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj dhe është në përpjesëtim të drejtë me fondin limit të procedurës. Vlera e xhiros është vendosur që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në mbështetje të Ligjit 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", neni 64 Deklarata Tatimore; Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore": "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare **2022, 2023, dhe 2024**, të konfirmuara me vulë pranë autoriteteve përkatëse (Administratës Tatimore), dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të ligjit Nr.10 091, datë 05.03.2009, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivit dhe pasivit.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", te ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e balanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjin nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe neni 41, pika "c", e ligjit nr.10091 date 5.3.2009 "Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar" i ndryshuar, në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", etj.

2.2.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë shlyer taksat për vitin **2024** dhe **2025** për adresën ku ai ushtron aktivitet sipas Ekstraktit Historik lëshuar nga QKR, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar, sipas përcaktimeve të ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “*Për sistemin e taksave vendore*”, i ndryshuar, referuar dhe përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, *ku nëse kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit*, duhet të paraqesë vërtetim/e lëshuar nga Bashkia me anë të së cilit të vërtetohet shlyerja e këtyre taksave sipas vetëdeklarimit të kryer në shtojcën 8 të DST-së. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, e LPP-së i ndryshuar, si dhe të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore. Shlyerja e detyrimeve vendore për vitin 2024 ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.*

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon:

- punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

Ose

- punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për plotësimin e këtyre kritereve Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- a-** vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës **ose/dhe** fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi *dhe të deklaruara në organet tatimore* ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b-** Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi *dhe të deklaruara në organet tatimore* ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe nenit 39, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar.

2.3.2 Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë se disponojnë liçensë profesionale për zbatim punimesh në ndërtim si dhe në liçensë të disponojnë kategoritë e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin liçensën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.42, datë 16.01.2008 "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së liçensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi", i ndryshuar.

Liçensa profesionale e operatorit ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

- | | | |
|---|--|----------------------|
| - | NP.1 – Punime Germimi ne toke | Klasifikimi A |
| - | NP-7 Punime ujesjellesa vepra kullimi e vaditje etj | Klasifikimi A |

* Për Operatorët e huaj të bëhet njehësimi i liçensës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Ministrisë së Punëve Publike Transportit dhe Telekomunikacionit në plotësimin e liçensave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.

* Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë, Liçensat profesionale duhet t'i paraqesë operatori ekonomik që ka marrë përsipër punimet për të cilat kërkohet Liçensa Profesionale.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", si dhe të ligjit nr.10081, datë 23.2.2009, "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 18, të ligjit nr.8402, datë 10.9.1998, "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar si edhe Vendimin nr. 42, date 16.01.2008 "Per miratimin e rregullores per kriteret dhe procedurat e dhenies se liçensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike, qe ushtrojne veprimtari ndertimi", pikat e licences dhe kategorite me klasifikimet perkatese caktohen duke u mbeshtetur ne punimet e parashikuara ne preventivin e objektit dhe ne vleren totale te punimeve per secilen kategori.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e punes, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatat ISO, si më poshtë:

- **ISO 9001:2015** (Sistem i Menaxhimit te Cilesise)
- **ISO 14001:2015** (Sistem i Menaxhimit Mjedisor)

- **ISO 45001:2018** (Sistem i Menaxhimi i sigurise dhe Shendetit ne pune)

Nese certifikatat jane ne gjuhe te huaj, ato te paraqiten te perkthyer dhe te noterizuara ne gjuhen zyrtare shqipe. Keto certifikata te jene leshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit i akredituar nga Drejtoria e Pergjithshme e Akreditimit ose nga organizmat nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise. Certifikatat duhet te jene te vlefshme ne kohen e zhvillimit te tenderit.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili operator ekonomik duhet te dorezoje certifikatat e mesiperme sipas natyres se punimeve qe do te marre persiper te realizoje, referuar kontrates se bashkepunimit te nenshkruar.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 pika 1/a dhe 2 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” në të cilët përcaktohet: “Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **aftësinë teknike dhe profesionale**;...Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë **se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme** njerëzore e **teknike**, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie”

Në nenin 44 “Kërkesat e cilësisë” të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 përcaktohet: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin **çertifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.**”

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se plotësojnë standartet e kërkuara të cilësisë, standartet për shëndetin dhe sigurinë në punë si dhe standartet e menaxhimit të mjedisit.

Në mbështetje të përcaktimeve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, autoriteti kontraktor vlerëson se:

Autoriteti kontraktor gjykon se operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të plotësojnë kërkesat e standarteve në lidhje me garantimin e cilësisë së punimeve objekt kontrate në mënyrë të qëndrueshme, ku referuar natyrës së punimeve që kërkohen të kryhen, njësia e prokurimit ka kërkuar çertifikatat e mësipërme për vërtetimin se operatorët ekonomikë i plotësojnë kërkesat e cilësisë për këto punime.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet te kete ne pronesi ose me qira mjetet e domosdoshme per realizimin e kontrates si me poshte :

Nr	Lloji i Makinerive	Statusi	Sasia
1	Eskavator me goma (MT)	në pronësi ose me qira	Copë 2
2	Ekskavator me zinxhirë	në pronësi ose me qira	Copë 1
3	Kamionçina 3.5-5 ton	në pronësi ose me qira	Copë 3
4	Minifadrome Bobcat I pajisur me trencher (MT)	në pronësi ose me qira	Copë 1
5	Kamion vetshkarkues	në pronësi ose me qira	Copë 1
6	Sharre për prerje Asfalti	në pronësi ose me qira	Copë 1

7	Ngjeshes asfalti	në pronësi ose me qira	Copë 1
8	Makineri elektrofuzive	në pronësi ose me qira	Copë 1
9	Kamion me vinc	në pronësi ose me qira	Copë 1

Për përmbushjen e këtij kushti, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë sipas formës së disponimit të mjeteve/ makinerive dhe pajisjeve të kërkuara më lart, në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të shtojcës 8 në DST, dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqiten:

Për mjetet me goma që shënohen në rregjistra publike duhet të paraqitet dokument që vërteton Rregjistrimin e mjetit (*leje qarkullimi*), Çertifikatën e Kontrollit Teknik (*të vlefshme*), Siguracionin e mjetit (*të vlefshme*), Taksat e paguara, Leje e transportit dhe foto e dukshme të mjetit.

Për mjetet e siguruar me qira, të paraqitet kontrata e lidhur për këtë objekt, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt e këtij prokurimi, shoqëruar me Akt - Pronësie origjinal ose fotokopje të noterizuar plus dokumentat që vërteton Rregjistrimin e mjetit (*leje qarkullimi*), Çertifikatën e Kontrollit Teknik (*të vlefshme*), Siguracionin e mjetit (*të vlefshme*), Taksat e paguara, Leje e transportit dhe Foto e dukshme të mjetit.

Për paisjet/ makineritë në pronësi të shoqërohen me Akt - Pronësie origjinal ose fotokopje të noterizuar (*kontrata shit-blerje, kontrata dhurimi, fatura tatimore shitje, deklaratë zhdoganimi*) dhe Foto e dukshme të pajisjes/ makinerisë (*të paktën 1*).

Për paisjet/ makineritë me qera të paraqitet kontrata e lidhur për këtë objekt, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt e këtij prokurimi, shoqëruar me Akt - Pronësie origjinal ose fotokopje të noterizuar (*kontrata shit-blerje, kontrata dhurimi, fatura tatimore shitje, deklaratë zhdoganimi*) dhe Foto e dukshme të pajisjes/ makinerisë (*të paktën1*).

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose distributori. Në rast paraqitje autorizim distributori duhet të paraqitet kontrata ose dokumenti i angazhimit midis prodhuesit dhe distributorit, për materialet (sipas preventivit)

Argumentimi: Paraqitja e ketyre dokumenteve eshte vlerësuar nga njesia e prokurimit pasi duke qenë se në objektin e prokurimit kemi të bëjmë me blerjen e materialeve dhe pajisjeve që do të vendosen në punimet objekt kontrate, bazuar në dispozitat e sipërcituara dhe referuar nenit 40 pika 6 të VKM-së Nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, duhet që këto materiale e pajisje të plotësojnë parametrat dhe standartet e kërkuara në

specifikimet teknike e përcaktuara në objektin e kontratës, ku për vërtetimin e përmbushjes së tyre, duhet të paraqitet dokumentacioni i kërkuar si: Autorizim prodhuesi ose distributorin.

2.3.6 License e leshuar nga Qendra Kombëtare e Liçencimit për "Grumbullimin dhe transportin e mbetjeve" më Kod III.2.B me kodet perkatese :

17 02 03 Plastike

17 05 04 Dhera dhe gure

17 05 06 Balta

17 05 08 Cakell

Argumentimi: Sipas punimeve te projektit punime të gërmimeve, prerje, sistemim territori etj., dhe kryerjen e transportit të tyre në vend-depozitimet e miratuara, bazuar në nenet 21, 37 e 57 të ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve"; VKM nr.575, datë 24.06.2015 "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte" ku transporti i mbetjeve kryhet nga persona që disponojnë licencë të vlefshme për transportin e mbetjeve, AK vlerëson se operatorët ekonomik duhet të jenë të liçencuar për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve inerte (Kodi III.2.B) sipas ligjit nr.10081 datë 23.02.2009 "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", në përputhje me përcaktimet e VKM nr.538, datë 26.05.2009 "Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta".

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të paraqesë grafikun e punimeve të detajuar, preventivin si dhe analizen e cmimeve per zerat e preventivit, (Bashkëlidhur DST) në dokumentat e tenderit. Ne rast BOE, grafikun e punimeve duhet te jete i firmosur dhe vulosur nga secili prej administratoreve perkates.

Argumentimi: Në nenin 15 pika 3/a të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 285, datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik" (i ndryshuar) ndër të tjerash parashikohet se: "a) Informacioni specifik për kontratat e punëve përfshin të paktën: - grafikun e zbatimit;" . Njësia e prokurimit referuar të dhënave teknike të projektit, ku parashikohet dhe afati i kryerjes së punimeve bazuar në grafikun e punimeve, vendosi miratimin e afatit të punimeve prej 30 diteve nga data e dorëzimit të sheshit të ndërtimit, vlerësuar si afat i mjaftueshëm për realizimin e kryerjes së punimeve objekt prokurimi.

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të ketë një punësimin mesatar jo më pak se 20 (njetzet) punonjës me kohë të plotë pune, për periudhën 3 (tre) muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave, ku përfshihen edhe Stafit menaxherial i Drejtuesve Teknik. Për përmbushjen e këtij kushti, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë sipas formës së disponimit të punonjësve në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të shtojcës 8 në DST, dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë:

1. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën e mësipërme.
2. Listëpagesat e Kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të konfirmuara nëpërmjet formës elektronike nga organet tatimore për periudhën e mësipërme.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

2.3.9 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë stafin kryesor e mbështetës, punonjësit specialistë dhe certifikimet përkatëse, si më poshtë:

a) Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë në liçencë të shoqërisë e të punësuar në stafin e tij teknik për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë noteriale pune (të vlefshme), diplomë përkatëse, CV, libeze pune, si dhe të figurojnë detyrimisht në listpagesat e shoqërisë për periudhën e kërkuar , stafi inxhinierik si më poshtë:

- Minimuni **1 (një) Inxhinier Hidroteknik**
- Minimuni **1 (një) Inxhinier Ndertimi Infrastrukture**

Disponimi i stafit inxhinierik do të deklarohet në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, si dhe *në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit* duhet të paraqesë dokumentacionin e kërkuar më lart.

Argumentimi: Së pari, kjo kërkesë mbështetet ne Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi teknik është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij **drejtues teknik** të cilët kanë një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e punimeve pasi ata janë përgjegjës për zbatimin e objektit sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të tij.

Kriteri për stafin teknik kryesor, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinjerët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Stafi i inxhinjerëve, është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

Inxhinieri Hidroteknik është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve hidroteknike, lidhur me zërat e punimeve të parashikuara në preventivin, sipas parashikimeve në projekt.

Inxhinieri i Ndërtimi profili Infrastrukture kerkohet për zbatimin e saktë të punimeve me karakter transporti sic jane punimet qe intersekojne ne rruge, si prerje asfalti dhe rindertim i shtresave te rruges.

b) Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar për kryerjen e punimeve sipas zerave të preventivit të punimeve, si më poshtë:

Hidraulik – 4 punonjës

Punëtorë - 6 punonjës

Saldator - 1 punonjës

Per punojesit e mesiperm duhet te paraqiten:

- Kontratat e punës individuale (të vlefshme).
- Certifikata/diploma për formimin profesional (të vlefshme), të cilat duhet të jenë të lëshuara nga institucione publike/private të licensuara sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.”, i ndryshuar.
- Te gjithë punojësit e mësipërm duhet të figurojnë në listepagesat të shoqërisë minimalisht për periudhën 3 mujore.
- Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë për punonjësit e mesiperm , emer/mbiemer, profili i punes, numri dhe datë e kontratës individuale të punës, numrin e amazes dhe titullin e kualifikimit për diplomën/certifikatën përkatëse si dhe emrin e institucionit që ka lëshuar dokumentin për specialistet e kualifikuar me siper.

Diplomat/certifikatat e paraqitura nga organizma të cilat nuk janë të licensuara sipas legjislacionit në fuqi do të konsiderohen si dokumenta të rreme të cilat përbëjnë shkak për skualifikim dhe/ose përjashtimin nga pjesëmarrja në prokurimet publike.

*Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8. Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas deklarata B.

Shënim: Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor do i kërkojë ofertuesit i kualifikuar i pari dorëzimin e dokumentacionit të mëposhtëm:

- a) Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklarate (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt i cili duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë, dhe të deklarojë se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, ku në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, për drejtuesin teknik të deklaruar, duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Librezë pune (përkatëse)
 - CV përkatëse
 - Kontratë noteriale pune e vlefshme (përkatëse)
 - Diplomë

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, secili operator ekonomik në bashkim, duhet të përcaktojë me anë të një deklarate, Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë dhe të deklarojë se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt në varësi të vlerës së preventivit të punimeve që ka marrë përsipër sipas përqindjes së bashkëpunimit.

Argumentimi : Kërkesat e gërmes b) të pikës 2.3.9, të kriterëve të veçanta për kualifikim, janë bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 15/2017 “*Per arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.*” dhe VKM nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, të rishikuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

- **Hidraulik – 4 (kater).** Eshte i nevojshem per ndjekjen dhe realizimin e punimeve dhe instalimeve hidraulike sipas zerave te preventivit. Per punimet hidraulike eshte kerkuar nje numer minimal punonjesish hidraulike.
- **Saldator – 1 (nje).** Eshte i nevojshem per realizimin e punimeve te saldimit sipas zerave te preventivit. Per punimet e saldimit eshte kerkuar nje numer minimal saldatoresh per saldimitin e flanaxhave te saracineskave etj

2.3.9 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, se ka pjesë të stafit të punësuar:

- Manovratore/Eskavatoriste - 4 punonjës
- Shofer - 4 punonjës

, të cilët duhet të figurojnë në listëpagesa të shoqërisë të punësuar për periudhën e kërkuar në pikën 2.3.8, në rastin kur mjetet/ makineritë e deklaruar janë në pronësi të operatorit ekonomik ofertues, në të kundërt kur mjetet/ makineritë disponohen me qera, ky staf i kërkuar mund të jetë i kontraktuar, **dhe në çdo rast, në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, për secilin të paraqiten:**

Per punojesit e mesiperm duhet te paraqiten:

- Kontratat e punës individuale të vlefshme.
- (Dëshmi të Aftësisë Profesionale), që të vërtetojë kualifikimin profesional të kërkuar, referuar rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtim dhe tokë, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre”, miratuar me urdhërin Nr. 200, datë 16.5.2019, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjitikës dhe referuar Kodit Rrugor, e cila duhet të perkojë me kërkesat e profilit të deklaruar për çdo punojës.
- Të figurojnë në listëpagesat e E-Sig minimalisht për periudhën e 3 (tre) muajve të fundit nga data e hapjes së ofertave, ku punojësit e mësipër duhet të figurojnë të regjistruar sipas legjislacionit në fuqi.
- Gjate fazes se ofertimit në plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, pika B. Deklarata -“Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate”, operatorët ekonomik për punonjësit eskavatoriste, shofere, duhet të deklarojnë: emer/mbiemer, profilin e punës, datën e kontratës së punës, numrin e dëshmisë së aftësisë profesionale dhe datën e vlefshmerisë së saj.

Ne rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë punojësit e mesiperm, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Argumentimi: Numri prej 20 punonjës përfshin 6 punonjes te thjeshte + 14 personat që janë stafi i kualifikuar i inxhinierëve dhe teknikëve, hidraulike, saldatore, drejtues mjeti, manovratorë, etj të përmendur më lart. Ky numër është llogaritur analitikisht në baze të zerave të preventivit dhe për llogaritjen e numrit të punonjesve janë marrë parasysh kombinimet e mundshme të punonjësve të specializuar dhe atyre të thjeshtë.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

AK rezervon të drejtën e verifikimit të deklarimeve për punonjësit e mesiperm, cdo informacion i rreme apo i devijuar nga kërkesat e mesiperme do të jetë kusht për skualifikimin e ofertes.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Argumentimi i specifikimeve teknike:

Shënim: Specifikimet teknike dhe termat e references, për shërbimet objekt prokurimi, shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha shërbimeve dhe standardeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të shërbimit, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e

tillë lejohe vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Specifikimet teknike dhe fondi limit i kontratës janë hartuar prej Autoritetit Kontraktor për nevojat e së cilës po kryhet kjo procedurë prokurimi.

Sipas specifikimeve bashkëngjitur të hartuar, vendosur dhe përlogaritur nga struktura të posaçme të specializuara, e konkretisht nga: “Grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe përlogaritjen e fondit limit”, mbështetur në Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Specifikime teknike, preventivi, afati dhe kriteret kualifikuese u pasqyruan në DT.

Dokumentet e tenderit me kërkesat si më sipër firmosen nga anëtarët e njësisë së prokurimit, pas miratimit të gjithë anëtarët e njësisë kanë akses (autorizohen) për botimin e tyre në rrugë elektronike pranë APP (www.app.gov.al).

Njesia e Prokurimit